

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BETON PART SHPK”

Në Durrës sot datë 17/10/2024 themelohet shoqëria **“BETON PART SHPK”** nëpërmjet ortakëve:

Z. Dritan Kokomani, I biri I Rexhep Kokomani, lindur në Shijak më 28/12/1971, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I kartës së identitetit me nr H11228114R

dhe,

Z.Pasquale Di Fiore, I biri I Antonio Di Fiore, lindur në Maddaloni (CE) më 07/10/1975, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I kartës së identitetit me nr CA03143GC.

Sa më sipër, bazua në ligjin nr.9901 datë 14/04/2008 për “Tregëtarët Dhe Shoqëritë Tregëtare si dhe ligjin nr.9723 për “Qendrën Kombëtare Të Rregjistrimit”, përpilojmë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi Të Kufizuar **“BETON PART SHPK”**

NENI I

Themelimi

Deklarojmë themelimin e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” BETON PART SHPK bazuar në ligjin nr.9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe ligjin nr.9723 dt.03/05/2007 “ Për Qendrën Kombëtare Të Rregjistrimit”

NENI II

SELIA

Selia e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” **BETON PART SHPK** është, Rruga nacionale Plepa-Tirane, objekt me nr.pasurie 63, Zona kadastrale 3236.

NENI III

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe person juridik në përputhje me legjislacionin shqipëtar ne fuqi dhe aktiviteti I saj rregullohet sipas dispozitave të statutit të kësaj shoqërie duke u bazuar dhe në këtë akt.

NENI IV

Kohëzgjatja

Kjo shoqëri do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

NENI V

1. Kjo shoqëri përfaqësohet tek të tretët nga administrator i saj Dritan Kokomani.
2. Dritan Kokomani caktohet si administrator I shoqërisë per nje periudhe 5 (pesë) vjecare.

NENI VI

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar I kësaj shoqërie është 1,000,000 (një milion) lekë,

E zotëruar prej ortakëve:

Z.Dritan Kokomani i cili merr pjesë në masën 50% (pesëdhjetë përqind) në këtë kapital
Dhe

Z.Pasquale Di Fiore i cili merr pjesë në masën 50% (pesëdhjetë përqind) në këtë kapital.

NENI VII

Objekti

Shoqëria ka si objekt aktivitetin kryesor prodhimin e mallrave, përfshirë edhe gjysmëproduktet, dhe ofrimin e shërbimeve, që përbën qëllimin kryesor të ndërmarrjes artizanale, si dhe aktivitetet komplementare, mjetësorë ose ndërprerëse në lidhje me aktivitetin kryesor.

Në veçanti shoqëria ka për objekt:

A) Ndërtimin, instalimin, shitjen, asistencën, mirëmbajtjen dhe riparimin e qendrave të betonimit dhe të ngjashme, civile, industriale, publike dhe private brenda dhe jashte vendit, përfshirë:

- Impjantet për gurore, silo, mullinj, sita rrotulluese dhe dridhëse, thërrmues, granulatorë, transportues me rrip dhe helikë;

- Impjantet për thërrmijëzim, ushqyes, impjantet mikronizuese, makinat për ndarjen e materialit të lehtë nga inertët, gurët, ndërtimin e rrotullave, karpenterinë metalike në përgjithësi, rripat magnetikë;

- Impjantet për gelqere llaçi, qeramikë dhe tulla;

- Impjantet për ngjitës, llaçe dhe pluhura;

- Impjantet ekologjike për përdorimin e mbeturinave ndërtimore, si dhe të gjitha aktivitetet e ngjashme, të lidhura, komplementare dhe të njësuara;

B) Tregtinë me shumicë dhe pakicë të makinave për transportin dhe pompimin e betonit, automjeteve industriale, makinave për lëvizje toke, pajisjet për transport dhe pompim të cementit, si dhe çdo automjet të lidhur me sektorët e sipërpërmendur;

C) Montimin dhe çmontimin e impjanteve industriale në përgjithësi;

D) Qiradhënien e automjeteve industriale, si dhe të makinave dhe impjanteve të lidhura me aktivitetet e sipërpërmendura, me ose pa operues;

E) Punimet rrugore në përgjithësi dhe të ngjashme;

F) Projektimin, realizimin, instalimin dhe tregtinë e impjanteve dhe aksesorëve, qëllonjë në automatizimin dhe kontrollin e proceseve industriale dhe impjanteve teknologjike, të integruara me sisteme informatike dhe/ ose telematike. Me këtë qëllim, ajo mund të ndërtojë impjante dhe/ ose produkte të reja, t'i transformojë, rindërtojë, riaktivizojë, zgjerojë, modernizojë.

Shoqëria mund të blejë dhe/ ose shfrytëzojë patenta dhe të kryejë transportin e mallrave si për llogari të vet ashtu dhe për llogari të palëve të treta. Ajo mund të kryejë operacione import-export, të marrë përfaqësime dhe agjenci të produkteve të lidhura me objektin social dhe të marrë pjesë në tenderë publikë dhe privatë.

Për arsyetimin e qëllimeve të shoqërisë, shoqëria mund të kryejë, në formë jo kryesore, të gjitha aktivitetet e nevojshme ose të dobishme, përfshirë operacione tregtare, industriale dhe të pasurive të paluajtshme, si dhe - me përjashtim të çdo operacioni të kryer "për dhe ndaj publikut" - mund të kryejë edhe operacione financiare dhe të mjeteve të lëvizshme, duke iu nënshtruar gjithmonë respektimit të normave që rregullojnë ushtrimin e këtyre aktiviteteve; mund të japë garanci reale në favor të palëve të treta, nëse është në interesin e shoqërisë; të përdorë çdo formë financimi me institucione kredie, banka, shoqëri dhe privatë, duke ofruar garancitë e nevojshme; të marrë pjesë në bashkime të përkohshme të ndërmarrjeve dhe të marrë përfjetësi në shoqëritë e tjera me objekt të ngjashëm ose të afër ose të lidhur me të tyre, përderisa nuk rezulton ndryshim në objektin social.

Për aktivitetet që duhen kryer në formë ekskluzive sipas normave në fuqi, shoqëria:

-do të sigurohet që të përfundohen paraprakisht regjistrimet e nevojshme në regjistrat e veçanta ose autorizimet specifike të parashikuara nga ligji. Në çdo rast, është e përjashtuar kryerja nga ana e shoqërisë e aktiviteteve që janë të rezervuara për profesionistët e veçantë, në përputhje me rregullat që rregullojnë profesionet, për ushtrimin e të cilave kërkohet regjistrim në regjistra ose lista të caktuara.*

Për rrjedhojë, kur të jetë e nevojshme, shoqëria do të përdorë profesionistë të licencuar sipas ligjit (qofshin ata anëtarë të shoqërisë apo të jashtëm), të cilët do të veprojnë personalisht nën përgjegjësinë e tyre direkte.

-Shoqëria, për aktivitetet dhe për të gjithë përfitimet fiskale, taksore, sigurimore dhe financiare* që bien në objektin social, mund të përfitojë nga financimet publike ose të tjera, që parashikohen nga legjislacioni aktual rajonal, kombëtar apo komunitar, ose në të ardhmen mund të jenë të disponueshme në bazë të dispozitave ligjore të miratuara në vijim.

NENI VIII

Fillimi I aktivitetit të saj tregëtar kjo shoqëri e lidh me rregjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare Të Rregjistrimit si dhe me pajisjen me leje dhe licensa të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit.

NENI IX

Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kësaj shoqërie mbrohen nga legjislacioni shqipëtar në fuqi.

THEMELUESIT

Dritan Kokomani



Pasquale Di Fiore

